



MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tirane

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Tiranë, Shqipëri

Nr. 273/6 Prot

Tiranë, më 18/03/2021

**RREGULLORE**

"PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT, DHE

MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT, NË S.U.O.GJ "KOCO GLIOZHENI"

**TIRANË**

Miratuar me datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021

# RREGULLA TE PËRGJITHSHME

## Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja "Për hetimin administrativ të sinjalizimit, të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, në SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë, bazohet në Ligjin nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", urdhrave dhe udhëzimeve të nxjerra për këtë qëllim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë ILDKPKI):

## Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje, në zbatim të legjislacionit në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit; përcaktimi i mënyrës dhe procedurës së hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja si dhe përcaktimi i mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë dhe të gjitha njësitë përgjegjëse të ngritura brenda tij, sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje.

## Neni 3 Përkufizime

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Autoritet publik" ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit<sup>1</sup>.
2. SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë është institucion shëndetësor publik, Universitar ku harmonizohet aktiviteti diagnostik dhe mjekues me procesin pedagogjik dhe kërkimor-shkencor. Në kuptimin e nenit 37, të Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni", në Tiranë është Spital Tërciar.

Ai është gjithashtu një qendër reference kombëtare. Ndodhet i vendosur në adresën: Bulevardi "Bajram Curri", Tiranë. Spitali Uneversitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni" sipas Vendimit të këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 10.09.2004 "Për disa ndryshime në VKM-në, Nr. 70, datë 15.02.2001, "Për statusin e Spitaleve Uneversitare" dhe sipas Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 29, datë 15.01.2001, është emërtuar "Spitali Uneversitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni".

3. "Organizatë" është autoriteti publik në këtë rast SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë.

Neni 2, pika 1/ a e tij, parashikon se: "Çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurën administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetut ose me ligj.

1 Njësia Përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

4. **“Njësia përgjegjëse”** është organi i posaçëm i caktuar brenda autoritetit publik, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës, i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të ligjit.

5. **“Sinjalizim”** është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse ose **SUOGJ “Koço Gliozheni” Tiranë**, për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik.

6. **“Sinjalizues”** është individ i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

7. **“I sinjalizuar”** janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas ligjit në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

8. **“Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni”** është një veprim ose mosveprim fakte ose rrethana të kryera në një organizatë për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim sipas këtij ligji se mund të përbëjë korrupsion.

9. **“Mbrojtje”** është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja sipas mekanizmit të përcaktuar në Kreun V të ligjit nr. 60/2016.

10. **“Hakmarrje”** është çdo veprim ose kërcënim i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, i kryer nga organizata me natyrë diskriminuese disiplinore ose që në një formë tjetër të padrejtë dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.

## PJESA I

### HETIMI ADMINISTRATIV I SINJALIZIMIT DHE MBROJTJA E KONFIDENCIALITETIT

#### KREU I

#### VEPRIMTARIA E NJËSISË PËRGJEGJËSE NË SUOGJ “Koço Gliozheni”

#### Neni 4

#### Parimet e veprimtarisë 1

- a) sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupsionit;
- b) integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;
- c) zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;
- d) procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

2. Njësia përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 60/2016, si strukturë që ndjek në vazhdimësi sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja në veprimtarinë e saj mban kontakte të vazhdueshme me ILDKPKI-në.



3. Njësitë përgjegjëse në SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë, veprojnë në mënyrë të pavarur dhe jashtë çdo influence tjetër të padrejtë që mund të pengojnë realizimin e detyrave të tyre në zbatim të ligjit nr. 60/2016.

#### Neni 5

#### Njësitë përgjegjëse në SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë

1. Njësitë përgjegjëse në SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë, ngrihen dhe funksionojnë në përputhje me nenin 10. pika 1. të Ligjit 60/2016 dhe VKM nr. 816, datë 16.11.2016. "Për strukturën kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".
2. Në SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë ngrihen dhe funksionojnë këto njësi përgjegjëse:
  - a) Njësia Përgjegjëse SUOGJ "Koço Gliozheni" për:  
Zyra e Burimeve Njerëzore.
3. Punonjësit e Njesisë Përgjegjëse largohen nga kjo detyrë me urdhër të titullarit të autoritetit publik kur:
  - a) japin dorëheqjen me shkrim nga detyra e njësisë përgjegjëse, e cila i dërgohet, njëkohësisht, edhe ILDKPKI-së;
  - b) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
  - c) kryejnë shkelje të rëndë të legjislacionit që rregullon sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;
  - d) përfundon marrëdhënien e punës me autoritetin publik.
4. Për çdo ndërprerje të marrëdhënies së punës ndërmjet autoritetit publik dhe punonjësit të Njesisë Përgjegjëse informohet menjëherë ILDK.PK.I-ja.

Titullari i autoritetit publik merr masat e nevojshme që të zëvendësojë menjëherë punonjësin e larguar të Njesisë Përgjegjëse me punonjës të strukturës përkatëse ose, sipas rastit, të strukturave të tjera duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

## KREU II

### PROCEDURAT E VEPRIMIT

#### Neni 6

#### Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të Njesisë Përgjegjëse, kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016, këtë Rregullore dhe për aq sa nuk rregullohet në to sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimi për veprimet procedurale për të cilat Njësia Përgjegjëse cakton afate, duhet të përmbajë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

## Neni 7 Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi në formë të shkruar ose deklarohet në mënyrë verbale, para punonjësit të caktuar të Njësive Përgjegjëse në SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë, dhe dokumentohet me shkrim prej këtij të fundit sipas Formularit të Sinjalizimit të Brendshëm.
2. Sinjalizimi të paktën përmban:
  - a) të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
  - b) të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
  - c) përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
  - d) referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;
  - e) në rastin e sinjalizimit tek Njësia Përgjegjëse, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.
3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga Njësia Përgjegjëse si i tillë vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.
4. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

## Neni 8 Mos fillimi i hetimit administrativ

1. Njësia Përgjegjëse ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse:
  - a) sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
  - b) sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 60/2016, sipas nenit 3, pika 6, të tij;
  - c) kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.
2. Mosfillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të Njesisë Përgjegjëse përkatëse.



## Neni 9

### • Hetimi i drejtpërdrejtë nga ILDKPKI

1. ILDK.PK.I-ja heton drejtpërdrejtë sinjalizimin për veprimet ose praktikën e dyshuara të korrupsionit në organizata të cilat nuk kanë një njësi përgjegjëse për këtë qëllim.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë veprën e dyshuar të korrupsionit edhe tek ILDKPKI-ja, sipas Formularit të Sinjalizimit të Jashtëm në rastet kur:

- a) njësia përgjegjëse nuk fillon hetimin administrativ ose përfundon hetimin në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 60/2016;
- b) ekziston dyshimi i arsyeshëm se priti i sinjalizimit në njësine përgjegjëse ose persona të lidhur me të janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, paquror ose personal, në veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Sipas rastit, personi i lidhur ka të njëjtin kuptim me përcaktimet e bëra në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ose ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;
- c) ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e njësise përgjegjëse në shqyrtimin e sinjalizimit;
- d) prova e sinjalizuesit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, mund të fshihet ose të shkatërrohet nga organizata.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, çdo hetim i njësise përgjegjëse, nëse ka filluar, ndërpritet dhe sinjalizimi hetohet në vijim nga ILDKPKI-ja. Në rast se nuk vërtetohen kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së me vendim të arsyetuar, e dërgon sinjalizimin për nisjen ose vijimin e hetimit administrativ tek njësia përgjegjëse e organizatës.

## KREU III

### • HETIMI ADMINISTRATIV

## Neni 10

### Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokollit i cili është edhe elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve.

2. Njësia Përgjegjëse nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

## Neni 11

### Parimet e hetimit administrativ nga Njësia Përgjegjëse

1. Në kryerjen e hetimit administrativ Njësia Përgjegjëse vepron:

- a) me ndershmëri paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitime të sinjalizuesit;
- b) në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;

- c) duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;
- d) duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
- e) duke majtur konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojtë të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
- f) duke ruajtur sekretin në përmbajtje të një sinjalizimi në zbatim të ligjit.

## Neni 12

### Procedura e hetimit administrativ

1. Njësia Përgjegjëse heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 60/2016 dhe në këtë Rregullore. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj dhe Rregullore, njësia zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njësia Përgjegjëse ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni mbi rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
3. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dëshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga Njësia Përgjegjëse.
4. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt ligjor, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:
  - a) mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
  - b) mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
  - c) ka të drejtë të dëgjohej në lidhje me pretendimet e tij etj.
5. Njësia Përgjegjëse njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, Njësia Përgjegjëse është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi në çdo kohë në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.
6. Njësia Përgjegjëse, për atë që është e mundur merr masa të menjëhershme dhe të çastit për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.
7. Njësia Përgjegjëse, nëse në përfundim të hetimit administrativ i rezultoi se, veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë sipas ligjit një shkelje administrative apo penale, vë në dijeni organin kompetent.

## Neni 13

### Provat në hetimin administrativ

1. Njësia Përgjegjëse dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë. Çdo



shkelje e detyrimit të zyrtarëve apo të organizatave private për dliënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues. përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.

2. Punonjësit e Njesisë Përgjegjëse kanë të drejtë të këqyrin sende vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbale me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.

3. Në raste të veçanta kur vlerësojnë se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore punonjësit e Njesisë Përgjegjëse bllokojnë dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga Njësia Përgjegjëse zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Zhblokimi i dokumentacionit bëhet me urdhërtë Titullarit të Institucionit.

4. Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e Njesisë Përgjegjëse zbatojnë, për aq sa mund të jetë e mundur, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

5. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga punonjësit dhe zyrtarët përgjegjës apo personat drejtues në institucion. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit, kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

#### **Neni 14 Përfundimi i hetimit administrativ**

1. Njësia Përgjegjëse përfundon hetimin administrativ në rast se:

- a) gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast Njësia Përgjegjëse njofton menjëherë Prokurorinë ose Policinë e Shtetit apo organe të tjera përkatëse;
- b) sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 60/2016.

2. Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për përfundimin e hetimit administrativ nga Njësia përkatëse Përgjegjëse në SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë, i cili është i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

### **KREL IV RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE**

#### **Neni 15 Konfidencialiteti**

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë, vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.

2. Njësia Përgjegjëse duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale, informacionin e



lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek personatë tretë apo përdorur për qëllime të tjera përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjal izuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

3. Njësia Përgjegjëse, në komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi ose me çdo subjekt apo autoritet tjetër privat ose shtetëror respekton detvrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshent vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara në kuadër të një marrëveshjeje konfidencialiteti mes palëve.

## Neni 16

### Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr. 60/2016. Në çdo rast përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të lejisllacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rastet kur në zbatimin e këtij ligji konstatohet mosrespektim i lejisllacionit për mbrojtjen e të dhënave personale çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## KREU V AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT ADMINISTRATIV

### Neni 17

#### Afati për vendimmarrjen

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga Njësia Përgjegjëse, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.
2. Shtyrja e afatit për hetimin administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të titullarit të institucionit, duke përcaktuar edhe afatin e ri kohor të shtyrjes në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.

DREJTOR



*DREJTUAR. Njësia Përgjegjëse të caktuar në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"*

I-Line sinjalizuesi \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_, vendlindja \_\_\_\_\_, banues në adresën: \_\_\_\_\_ dhe me kontakte \_\_\_\_\_, me detyrën e \_\_\_\_\_ në

paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon: 2-Unë sinjalizuesi zgjedh të mbetem anonim duke shpjeguar qartë dhe në mënyrë të arsyetuar shkaqet e anonimatit si më poshtë: paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, prova përkatëse që paraqes janë si më poshtë:

Nuk kam prova përkatëse, por ato mund të gjenden \_\_\_\_\_

Për këto arsye, kam dyshime për ekzistencën e një fakti që përbën veprën penale të parashikuar nga neni \_\_\_\_\_ i Kodit Penal (nëse është e mundur tapërcaktoni një gjë të lillë.)

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më / \_\_\_ / në \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, punonjës i Njësia Përgjegjëse në \_\_\_\_\_

Sinjalizuesi Emër  
Mbiemër  
Emër Mbiemër

Njësia  
përgjegjëse I-



*DREJTUAR: Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pusurive dhe Konfliktit të Interesave në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"*

1-Unë sinjalizuesi \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_, vendlindja \_\_\_\_\_, banues në adresën: \_\_\_\_\_ dhe me kontakte \_\_\_\_\_, me detyrën e \_\_\_\_\_ në

paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon: 2-Unë sinjalizuesi zgjedh të mbetem anonim duke shpjeguar qartë dhe në mënyrë të arsyetuar shkaqet e anonimatit si më poshtë:

Paraqes këtë sinjalizim në ILDKPKI, për arsye se :

1- \_\_\_\_\_ nuk ka Njësi përgjegjëse në zbatim të ligjit nr. 60/2016.

dhe paraqes sinjalizimin si inë poshtë:

2- Njësia përgjegjëse në \_\_\_\_\_ për sinjalizimin e paraqitur më datë \_\_\_\_\_

(bashkëlidhur formulari i sinjalizimit të bërë), pranë njësisë:

nuk filloi hetimin administrativ ose e përfundoi atë në kundërshtim me ligjin nr. 60/2016.

zoti/zonja \_\_\_\_\_ që pret sinjalizimin ose zoti/zonja \_\_\_\_\_ janë përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë personal ose material me objektin e sinjalizimit sepse \_\_\_\_\_

Dvshoj në integritetin dhe pëanshmërinë e Njësisë përgjegjëse për shkak sepse Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, provat përkatëse që paraqes janë si më poshtë:  
Nuk kam prova përkatëse, por ato mund të gjenden \_\_\_\_\_

Për këto arsye, kam dyshime për ekzistencën e një fakti që përbën veprën penale të parashikuar nga neni \_\_\_\_\_ i Kodit Penal (nëse është e mundur tapërcaktoni një gjë të tillë.) Ky formularsinjalizi mi u mor në dorëzim më / \_\_\_\_\_ / në nga \_\_\_\_\_, Inspektor në ILDKPKI.

Inspektor Emër  
Mbiemër

SinjalizuesiEmë  
r Mbieme